



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 26 datë 13.9.2023

“PËR KALIMIN E MJETIT AMBULANCË TEK NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR SHKODËR, PËR QENDRËN SHËNDETËSORE DAJÇ”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të dates 13.9.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit Nr. 10 138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”; Ligjit Nr.10 107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; VKM -së Nr.405, datë 20.5.2020 “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në shqipëri 2020-2025”; VKM –së Nr. 210, datë 6.4.2022 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të shëndetësisë 2021-2030”; VKM-së Nr. 866, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”; Udhëzimit Nr.30, datë 27. 12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Udhëzimit Nr.1, dt. 03.01.2018 “Mbi operacionet e privilegjuara”, i ndryshuar; Aktit të dhurimit nr. 17905 prot. Datë 30.11.2022 mes Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës Confraternita MISERICORDIA CASALGUIDI E CANTAGRILLO ODV-ETS, procesverbalit të marrjes në dorëzim me nr 18144/2 prot, datë 09.12. 2022, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Të miratojë kalimin e mjetit ambulancë FIAT – DUCATO – telaio, me Nr. shasie ZFA 25000001058810, me vlerë 116,860 lekë tek Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, për Qendrën Shëndetësore Dajç.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion L. LLA



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratur me 38 vota

Vota Pro 38

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 18.9.2023